

## Marrëveshje për mbrojtjen e të dhënave personale

Në mënyrë që të llogariten Benefit-et sipas Benefit Program-it, myWorld Kosovo Shpk, Rr. Fatime Sokoli nr 31, Kalabira, 10000 Prishtinë, Kosovë mbledh, përpunon dhe ruan të dhënat personale të Anëtarit, veçanërisht emrin dhe mbiemrin e tij, titullin, gjininë, datën e lindjes, adresën e postës elektronike/email, adresën postare, koordinatat e adresës (gjerësia dhe gjatësia), numri/at i/e telefonit , numri i faksit, ID-ja e anëtarit, detajet e llogarisë bankare (banka, IBAN, SWIFT dhe mbajtësi i llogarisë) si dhe informacionin rreth zakoneve të shit-blerjeve dhe blerjes së Anëtarit (data, vendndodhja dhe koha e blerjes, shuma e blerjes, valuta, informacioni i shportës së blerjeve, sektori, lloji i blerjes (*online, offline*, mesazhet; llogaria kyç, me CashbackmyWorld Card). Kur përpunon të dhënat e sipërpërmendura, myWorld Kosovo Shpk, Rr. Fatime Sokoli, nr. 31, Kalabria, Prishtinë 10000, Kosovë, mund të përdorë gjithashtu si përpunues të të dhënave myWorld International AG (Grazbachgasse 87-91, 8010 Graz, Austri) dhe Lyconet Global AG (Thurgauerstrasse 132, 8152 Glattpark (Opfikon), Zvicër).

Anëtari nëpërmjet këtij akti jep pëlqimin e tij - nga i cili mund të heqë dorë në çdo kohë - që myWorld Kosovo Shpk, Rr. Fatime Sokoli nr 31, Kalabira, 10000, Prishtinë, Kosovë mund të përpunojë të detajet e të dhënave të tij personale të përmendura më sipër me qëllim të kontaktimit me të me postë ose personalisht nga nga myWorld Kosovo Shpk, Rr. Fatime Sokoli, nr. 31, Kalabria, Prishtinë 10000, Kosovë me telefon ose me anë të dërgimit automatik të njoftimit ("*push notification*") për t'i bërë reklamë Benefit Program-it ose ofertave të myWorld dhe Kompanisë Partnere.

Anëtari gjithashtu jep pëlqimin e tij - nga i cili mund të heqë dorë në çdo kohë - që informacioni i mëposhtëm mund t'i ofrohet Rekomanduesit<sup>1</sup> të Anëtarit me qëllim krijimin e kontaktit në lidhje me Kompanitë e reja Partnere, mundësitë e reja të blerjes ose ofertat speciale: ID-ja e Anëtarit, emri dhe mbiemri, adresa e email dhe numri i telefonit.

Anëtari jep pëlqimin e tij - nga i cili mund të heqë dorë në çdo kohë - që myWorld Kosovo Shpk, Rr. Fatime Sokoli, nr. 31, Kalabria, Prishtinë 10000, Kosovë, autorizohet t'i paraqesë Rekomanduesit të e tij të drejtpërdrejtë dhe Rekomanduesin të tij (këtu e tutje referuar si Rekomandues indirekt) të dhënat në vijim në lidhje me zakonet e tij të shit-blerjes dhe blerjet për t'i mundësuar atyre të shohin aktivitetet e tij të blerjeve për qëllime llogaritëse: data e blerjes, koha e blerjes, emri dhe mbiemri, shuma e blerjes dhe valuta. Në vend të emrit të plotë të Anëtarit, Rekomanduesi indirekt do të shohë vetëm emrin e Anëtarit dhe shkronjën e parë të mbiemrit të tij.

Anëtari mund të tërheqë pëlqimin (et) e tij (edhe veçmas) me shkrim tek myWorld Kosovo Shpk, Rr. Fatime Sokoli, nr. 31, Kalabria, Prishtinë 10000, Kosovë ose me email në [service.xk@myworld.com](mailto:service.xk@myworld.com) në çdo kohë me efekt të ardhshëm. Pëlqimi i dhënë në këtë akt për përpunimin e të dhënave personale është i vlefshëm deri kur Anëtari ka tëhequr këtë pëlqim. Nëpërmjet këtyre të dhënave të kontaktit, Anëtari gjithashtu mund të ushtrojë të drejtën e tij për të kërkuar informacion, kryer ndryshime, fshirje, kufizime në lidhje me përpunimin etë dhënave dhe transferimin e tyre.

---

<sup>1</sup> Siç është përcaktuar në Kushtet e Përgjithshme të biznesit për anëtarët e myWorld